



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2019



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i I-rë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019

Më 19.02.2019

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Afrim Halili, Komandant i Policisë-Kaçanik

Ali Vishi, përfaqësues i FSK-së

Kjani Sallahu, (mediet, OJQ-të, zejtaret, PAK-të)

Fatmir Qaka, EVSB

Ramadush Osmani-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Fadil Guri-Zyrtarë për Komunitete dhe Kthim

Lirije Luta-Komiteti për Komunitete

Menduh Rexha-Bashkësia Islame

Shemsedin Abazi-(KLSP)

Vedat Dema-Zyra për Barazi Gjinore

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut **z.Besim Ilazi** dhe propozoi këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut
- 3.Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSB gjat vitit 2018
- 4.Të ndryshme

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar

- Procesverbali u miratua nga të pranishmit

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut

-Reth kësaj pike raportoi **Komandanti i Policisë** i cili dha një raport të detajuar për periudhën në mes dy takimeve.Situata e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve ka rezultuar e qetë dhe nuk kemi pasur ndonjë rast që ka ndikuar në prishjen e rendit dhe sigurisë publike.Kemi prezantuar një raport pune për vitin 2018 në lidhje me sfidat,të arriturat dhe aktivitetet që kemi pasur vitin e kaluar.Krahasuar nga viti paraprak dmth. Nga viti 2017 ,në vitin 2018 kemi pasur një ulje të veprave kriminale . Në pu nimet e autostradës kemi pasur raste të natyrave të ndryshme si në vjedhje, incidente në punë ,mosmarrveshje dhe raste tjera me të cilat jemi ballafaquar , dhe ne jemi munduar të kryejmë punën tonë që na takon.

Në përgjithsi kemi pasur 50 raste më pak në krahasim me vitin paraprak , 30% ulje të aksidenteve në komunikacion , ndërsa numri i xhobave në trafik ka qenë më i madh.

Fokus i veqant i yni përmes aktiviteteve të ndryshme ka qenë parandalimi i dukurive negative , ku ne kemi pasur një plan operativ me të cilin plan do të vazhdojmë edhe kët vit dike përdorur të gjith potencialin tonë.Problematikë po na paraqitet hapsirat jo të mjaftueshme për parkingje në qytet dhe kërkoj nga Komuna që mundësish të hulumtojë hapsirë me qëllim të zbutjes së kësaj dukurie.

Fatmirsisht nuk ka pasur bllokim të qytetit dhe gjithashtu kërkoj nga inspektorët komunal që të bashkëpunojnë me ne me qëllim që të vendoset rendi dhe qetësia publike.

-Kryetari: Falënderojmë Komandantin për kët informacion njëherit vlersojmë punën e policisë që kanë bërë.Kam pranuar një raport nga Komandanti i Policisë në lidhje me punën dhe aktivitetet të këtij institucioni dhe në përgjithsi jam i kënaqur me angazhimin e tyre.Fatkeqësisht vitin e kaluar kemi humbur dy zyrtarë policorë dhe uroj që këto raste mos të na ndodhin kurr .Mendoj se duhet një bashkpunim dhe angazhim i përbashkët në

parandalimin e përdorimit të substacave narkotike , një dukuri e shëmtuar që ka marrë përmasa në gjith vendin.

Shemsedin Abazi: Disa herë është thyer objekti sportiv në stadionin e qytetit dhe dëmet janë të konsiderueshme.Dëshiroj të dijë se a ka diqka konkrete në zbulimin e këtij rasti?

Komandanti i Policisë:Ky rast më shumë i përket vandalizmit ngase nuk kan pasur se çkatë marrin në kët objekt.Jemi duke punuar në zbardhjen e këtij rasti.

Fadil Guri: Propozoj që policia civile të ishte nga komunat tjera ku ndoshtado të ishte më mirë nga ana praktike në zbulimin e rasteve.

Komandanti i Policisë:Për momentin nuk e kemi atë mundësi por që sipas mendimit tim nëse nuk njihemi edhe bashkpunimi ka me qenë i mangët.Zyrtarët policorë i kemi profesionist të cilët edhe kanë arritë suksese.

Lirije Luta:Më intereson të dijë se a egziston ligji për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sa respektohet ky ligj?

Komandanti i Policisë:Ligji është dhe respektohet,në të kundërtën ata që nuk e respektojnë ndëshkohen.

Menduh Rexha:Më datë 08.01.2019 janë thyer zyret e Bashkësisë Islame në Kaçanik dhe dëmet janë të konsiderueshme.Falënderojmë Policinë e Kosovës të cilët kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë kryer punë e tyre por që diçka konkrete në zbulimin e autorëve nuk ka.Nuk di se sa janë efektive kamerat e sigurisë në zbulimin e këtyre rasteve.

Komandanti i Policisë:Jemi të njoftuar me kët rast dhe procedurat e hetimeve janë duke vazhduar.Kamerat e sigurisë janë efektive dhe deri më tani janë zbuluar mbi 50 raste por që jo të gjith herë na kan dhënë dëshmi që dëshirojmë.Pra edhe në kët rast nuk kemi mundur të marrim dëshminë e duhur.

Kjani Sallahu: Vitin e kaluar është bërë një rekrutim i zyrtarëve policorë dhe mendoj që ka pasur plotësim të stafit edhe në stacionin e policisë në Komunën tonë.Më intereson të dijë se sa ka ndikuar në punën e juaj ky rekrutim.

Komandanti i Policisë: Ky rekrutim nuk premton edhe aq shumë ngase një numër i zyrtarëve policorë dalin në pension , ndërsa të rinjët janë barrë për ne ngase me rastin e punsimit të tyre ata e kanë fazën e trajnimeve dhe janë barrë për ne.

3. Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSBB gjat vitit 2018

Kjani Sallahu: Propozoj që ekzekutivi komunal t'i merrë rekomandimet e dala nga viti i kaluar dhe të bëjë një selektim të punëve që janë kryer, ndërsa në takimin e radhës të kemi një pasqyrë se qfarë punë janë kryer në lidhje me sigurinë publike e çka nuk janë kryer.

Kryetari: Nga rekomandimet e nxjerrura jo vetëm ekzekutivi por të gjithë ne që jemi këtu duhet të mirremi me kët punë ngase përgjegjësia është e të gjithve.

6. Të ndryshme

Fadil Guri : Rruga në fshatin Nikaj që të qon te antena e Valës ,si pasojë e krijimit të një hendeku është e vështirë të kalohet .Ky hendek është krijuar qëllimi që sugjeroj që të dilet në kët vend dhe të bëhet një vlerësim i dëmit.Gjithashtu në kët pjesë të fshatit në një lëndinë është bërë një katrahurë me biznese të ndryshme të cilat e kanë shkatruar edhe ambientin.Pra sugjeroj që inspektorët të dalin në teren dhe ta vlersojnë kët gjendje.

Shemsedi Abazi:është një shqetësim i lagjës Zmak në fshatin Ivajë në lidhje me dëmtimin e dy shtyllave të tensionit të lartë që po paraqesin jo siguri te ky komunitet.Ky problem egziston në një kohë prej dy viteve dhe ende nuk është intervenuar .Duhet të dilet në kët teren dhe të vlersohet gjendja dhe të intervenohet sa ska ardh deri te më e keqja.

Kryetari: Lidhur me hendekun e krijuar në fshatin Nikaj ne do ti angazhojmë inspektorët komunal në vlersimin e dëmit.Gjithashtu zyrtarët do ti angazhojmë edhe tek ajo lëndinë me biznese dhe do të mirremi seriozisht me kët çështje .Sa i përket dëmtimit të shtyllave elekrike në lagjën Zmak ne nuk kemi pasur informacione ,kështu që do ta vlersojmë gjendjen dhe do ta ngrisim kët shqetsim ne Kompaninë KEDC.

Kjani Sallahu: Është një shqetësim i banorëve të lagjës "2 Korriku", lidhur me mbeturinat të cilat nuk janë marrë një kohë të gjatë. Të kontaktohen kompania dhe të sqarohen kjo situatë. Një çështje tjetër që është ngritë edhe në të kaluarën në lidhje me hendekun e krijuar në magjistrale afër vendit "Uji i Nxehtë", deri më tanë nuk ka pasur asnjë iniciativë për të intervenuar.

Në mbledhjen e KPF-së nga disa anëtarë të opozitës janë ngritë disa kritika ndaj KKSBB-së, sipas tyre, për mos punë efikase, por jam i vetëdijshëm se ata ende nuk e kanë mësuar e kuptuar rolin e KKSBB-së. Këtu më shumë ka tendencia se sa që janë preokupime të tyre. Tjetër, në mënyrë të tërthortë i kam përmendur edhe më herët veprimet e një zyrtari

komunal i cili për interesa personale dhe duke e përdorur një eksponent të tij i cili tërë ditën bredhë rrugëve, po tenton të pengojë projekte e të nxisë konflikte në komunitetin e fshatit Biçec, mu në kohën ku aty vrullshëm po punohet në shumë fronte dhe shumë projekte. Ky është provokimi i tretë i tij e që për target e ka një adresë të caktuar. Meqë është zyrtar komunal dhe dikush duhet të ketë mbikëqyrje ndaj tij, ju bëj ftesë që të mirren masa që këtyre praktiva t'u jepet fund njëher e mirë.

Kryetari: në lidhje me hendekun në maxhistrale ne e kemi ngritë dhe do ta ngrisim prap si shqetësim në nivelin qendrorë, e sa i përket zyrtarit komunal për veprimin e tij ne përgjigjemi mbrenda orarit të punës nëse një gjë e tillë ndodhë. Zyrtare ndonjë ankesë ndaj tij nuk kemi. Administratorët lokal janë përgjegjës për qdo gjë që e preukupojnë komunitetitn dhe deri më tani nga administrator I këtij fshati nuk kemi pasur diqka nlidhje me kët rast.

Ramadush Osmani: rreth shërbimit të menagjimit të mbeturinave ne kemi ankesa të vazhdueshme. Problemi është se kompania nuk ka makineri të mjaftueshme po edhe ato që I kan në dispozicion jan shum të amortizuara dhe kan defekte të koh pas kohshme. Janë ofruar donator si Qeveria japoneze për donacion për paisjen e kësaj kompanie me makineri më moderne. Ruga „2 Korriku” për shkak të terenit jo të përshtatshëm shpesh ndodhë që mos ta ket shërbimin e duhur sidomos kur kushtet atmosferike nuk jan të mira. Duhet që banorëve të kësaj ane mos ti fakturojmë për kohën kur ata nuk e kan pasur shërbimin.

Fadil Guri: Në momentin kur kompania fiton tenderin për kryerjen e shërbimit, qytetarëve nuk ju intereson për problemet teknike të kompanisë. Kompania duhet të kryejë shërbimin ose të hjek dorë nga kjo punë.

Ramadush Osmani: Kemi pasur takime me menaxhmentin e kësaj kompanie dhe I kemi diskutuar këto qështje. Ne jemi duke punuar edhe me rregullorën për menaxhim të mbeturinave dhe do të mundohemi që qytetarëve tu ofrojmë shërbim. Operimi I kompanisë do të bëhet sipas marrëveshjes së nënshkruar, ndërsa për ndërmarrje komunale të pastërtisë ne nuk kemi mundësi që ta vëmë në funksion.

Ali Vishi: rruga Bob- Doganaj pas nivelizimit të tokave me rrugën po shkakton problem me ujrat të cilat përshkojnë kët rrugë dhe janë duke e dëmtuar. Nivelizimi është bërë por nuk janë rregulluar kanale për ujë.

Kryetari: Në bisedime me kompaninë Bechtelenka ne kemi marrë premtim që rrugët e dëmtuara si pasojë e punimeve në autostradë do të rregullohen e sa I përket kanaleve të ujrate që nuk janë bërë, kjo është përgjegjësi e pronarëve të tokave. Ne do të bisedojmë edhe me pronarët e tokave dhe do të bëjmë zgjidhje.

Kjani Sallahu: Njësia operative e Pastërtisë nuk është treguar kreative në punën e saj. Mendoj se problemi kryesor qëndron te menaxhmenti i kësaj kompanie. Nuk ka mundësi që në këtë kompani qe 10 vjet nuk ka ngritje të kapaciteteve teknike-operative. Prandaj, duke insistuar edhe në ndryshimin e ligjit dhe duhet të punohet në atë drejtim që të barten kompetencat nga niveli rajonal në atë lokal ose që ky shërbim t'i besohet sektorit priovat. Për faktin që komuna është edhe investitore në këtë kompani, për të ciën ka blerë mbi 3 mijë kontejnera për ekonomitë familjare, ajo duhet ta obligojë Kompaninë për largimin e deponive të mbeturinave.

Kryetari: Probleme të ngajshme me kompanitë rajonale kanë edhe komunat tjera Kanta për mbeturina ka mjaftueshëm por makineri për mbledhjen e mbeturinave janë të pa mjaftueshme.

Ne si komunë do të kërkojmë disiplinë pune nga kompania. Po shpresojmë që me një donacion të mundshëm nga Qeveria japoneze, do të zbutet kjo gjendje në kompani.

REKOMANDIMET:

- 1.Të punohet bashkërisht në luftimin e dukurive negative
- 2.Të hulumtohen hapsira për parkingje
- 3.Të bëhet selektimi i punëve të kryera të nxjerrura nga rekomandimet e vitit të kaluar
- 4.Të intervenohet në hendeqet e krijuara nëpër disa rrugë
5. Kompania.KEDC të tregoj seriozitet në punën e tyre
- 6.Të mos pengohen iniciativat e mira të qytetarëve nga zyrtarët komunal
- 7.Kompania „Pastërtia” të kryejë shërbimin e duhur ndaj qytetarëve.

Pas këtyre rekomandimeve Kryetari përmbylli takimin për tu takuar në mbledhjen e radhës

Kaçanik 19.02.2019

Kryesuesi:

Kryetari i Komunës

z.Besim Ilazi

[Handwritten signature]



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka

[Handwritten signature]